

Komuna e Lipjanit zgjodhi kryesinë e vendeve rurale, të dielën


Votimet përcaktuan 37 krerë fshatrash pa përfaqësim femre

PDK-ja ka fituar në 28 fshatra, derisa LDK-ja në vetëm 4 sish. Në 2 fshatra kanë fituar 2 kandidatë të pavarur, kurse nga një fshat e kanë fituar AAK-ja, LDD-ja e AKR-ja

KOHA
ditare

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 11 KORRIK - Komuna e Lipjanit ka përzgjedhur kryesinë e vendeve rurale nëpërmjet votimeve të organizuara, deri në orën 23 të së dielës, derisa po këto votime kanë përcaktuar edhe 37 udhëheqës të rinj fshatrash të kësaj komune. Femra ka arritur të marrë pothuajse zero përfaqësim në kryesinë e porsazgjedhura të fshatrave të Lipjanit, një vendvotim është anuluar për shkak të parregullsive në Rufc të Ri, ndërsa PDK-ja ka fituar në 28 fshatra, derisa LDK-ja në vetëm 4 sish. Në 2 fshatra kanë fituar dy kandidatë të pavarur, kurse nga një fshat e kanë fituar AAK-ja, LDD-ja e AKR-ja. Idriz Krasniqi, udhëheqës i Komitetit për Çështje Qytetare, që edhe ka organizuar zgjedhjet ka deklaruar të hënën se këto zgjedhje kanë nisur organizimin qysh prej një muaji dhe ato sipas tij kanë qenë në rregull. "Konkurrenca ka qenë e madhe, derisa pjesëmarrja ka qenë e të gjitha partive, përjashtuar LDK-në që në disa raste ka bojkotuar zgjedhjet. Ka pasur edhe dy femra në një fshat që janë përfshirë në kryesi, mirëpo që nuk janë zgjedhur në shumicë. Zyrtarët e zgjedhur tashmë lidhen direkt me kryetarin e Komunës për të përfaqësuar legalisht interesat e vendeve prej nga vijnë", ka thënë ai, derisa ka konfirmuar se në Rufc të Ri është anuluar vendvotimi për shkak të parregullsive. Mësohet se




Femra ka arritur të merrte pothuajse zero përfaqësim në kryesinë e porsazgjedhura të fshatrave të Lipjanit, në zgjedhjet e së dielës për krerë fshatrash

kreu komunal më vonë do t'i lëshojë vendimet sipas të cilëve edhe do të njihen zyrtarisht të zgjedhurit nëpër fshatra. "Kuvendi Komunal ka përcjellë zgjedhjet nga afër dhe ato kanë kaluar në frymën më demokratike të mundshme", ka thënë, ndërkaq, Lulzim Rustemi, kryesues i KK-së. Ndërkohë që, rreth zgjedhjeve në fjalë të hënën është deklaruar edhe shoqëria civile e kësaj komune që e ka përcjellë nga afër procesin. Organizata joqeveritare e të rinjve YAHR ka evidencuar parregullsi në disa raste. "Organizata jonë gjatë monitorimit ka vërejtur disa parregull-

si, siç ishte rasti me Poturovcin ku një person ka votuar disa herë me letërnjoftime të familjarëve. Në disa fshatra ka pasur edhe bojkot nga subjektet politike, ndërsa në asnjë fshat s'ka pasur anëtarë të zgjedhur nga gjinia femërore, duke mos u respektuar me këtë rast rregulli prej 30 për qind, e që nuk do të duhej të ishte ashtu", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR. Sipas këtij të fundit, në orët e vona të së dielës është raportuar edhe për një incident në fshatin Sllovi, e ku kjo është evidencuar edhe në procesverbalin e votimeve.

Dështon edhe takimi

Për m takim



"Takimi" i së hër

KOHA
ditare

EKREM R

KAÇANIK, 11 KORRIK - Sikur para një jave, edhe të hënën mi i Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi të Kaçanikut dështuar të sigurojë kuorun. Është konstatuar prania e v 5 anëtarëve, nga 12 sish sa gjithsej këshilli. Të gjendur dilemës për shtyrje apo j takimit, anëtarët e pranis janë pajtuar për debat jofo gjatë të cilit gjendja e siguris Komunën e Kaçanikut ë vlerësuar e mirë. "Gjendja e urisë në rajonin e përgjegjësi Stacionit Policor të Kaçan vazhdon të jetë e mirë", ka t suar togeri Jaser Jaha, u komandantit të Stacionit Po të Kaçanikut. Ai ka kërkuar Komuna bashkërendim të v imeve për ndaljen e nd akustike nga kafenetë, ndërs